



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 1774 Prot.

Tiranë, më 01.06.2025

VENDIM

Nr. 132, Datë 23.06.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONI PËR
PROKURORIN ODETA TODORUSHI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar
6. Ledina RIZA	Anëtar
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.06.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Odeta Todorushi”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 1774 prot., datë 19.06.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi relatorin zotin Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* është institucioni që garanton pavarësinë, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Brenda kompetencave ligjore dhe nënligjore, Këshilli shqyrton, miraton ose refuzon kërkesat e prokurorëve për veprimtari jashtë funksioni.
2. Në datë 16.06.2025 pranë Këshillit është administruar me nr. 1711 Prot., kërkesa për veprimtari jashtë funksionit të Prokurorit, e magjistrates Odeta Todorushi, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, transferuar përkohësisht në prokurorinë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Prokurorja në kërkesën e saj qartëson se *angazhimi i referohet përfshirjes si eksperte e OSBE-së në trajnimin me temë "Trajnimi Kombëtar mbi Përgjigjet Efikase të Policimit ndaj dhunës me bazë Gjinore për Kadetët e Policisë në Shqipëri". Trajnimi do të realizohet në datat 23-26 qershor 2025, në ambientet e Akademisë së policisë në Tiranë, nga ora 08:30 deri në orën 16:40.*
4. Prokurorja bën me dije në kërkesë e saj se, rimbursimi financiar do të jetë sipas referencave përkatëse të aplikuara në çdo rast nga OSBE.
5. Në kërkesën e paraqitur për miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni, prokurorja Odeta Todorushi shprehet se:

E gjithë veprimtaria jashtë funksionit do të jetë në përputhje me parashikimet ligjore si për sa i përket kohëzgjatjes, po ashtu edhe natyrës së veprimtarisë dhe do të ushtrohet brenda orarit zyrtar".
6. Nga shqyrtimi i kërkesës dhe informacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurorja Odeta Todorushi nuk është subjekt procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi.
7. Ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij. Veprimtaria jashtë funksionit:
 - është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
 - nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magjistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit.
 - nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;

- nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

8. Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit arriti në përfundimin se, kërkesa e prokurorit për të ushtruar veprimtari jashtë funksioni sipas objektit të saj përmbush kriteret ligjore.
9. Për rrjedhojë, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxheti i propozoi Këshillit, miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Odeta Todorushi si eksperte e OSBE në trajnimin me temë “Trajnimi Kombëtar mbi Përgjigjet Efikase të Policimit ndaj dhunës me bazë Gjinore për Kadetët e Policisë në Shqipëri”, i cili do të realizohet në datat 23-26 qershor 2025.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166, pika 2, 189 pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokurorin Odeta Todorushi si eksperte e OSBE, në aktivitetin me temë “Trajnimi Kombëtar mbi Përgjigjet Efikase të Policimit ndaj dhunës me bazë Gjinore për Kadetët e Policisë në Shqipëri”, që do të realizohet në datat 23-26 qershor 2025.
2. Ky vendim i njoftohet Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë dhe prokurorit Odeta Todorushi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.06.2025.

KRYETAR
Mirela Bogdani

